



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.119 dt.05.08.1997

**PER
FINANCIMIN NGA TE ARDHURAT E BASHKISE
PER BLERJE USHQIMESH, DRU ZJARRI,
PAGESE TE ENERGIJE ELEKTRIKE ETJ.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mjedisit për financimin nga të ardhurat e Bashkisë për blerje ushqimesh, dru zjarri, pagesë të energjisë elektrike etj, për nevojat e çerdheve të fëmijëve dhe në mbështetje të nenit.14 të ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”

VENDOSI

1. Dhënien e fondeve nga të ardhurat e Bashkisë Drejtorisë së Qendrës Ekonomike të Çerdheve për blerje ushqimesh, dru zjarri, pagesë të energjisë elektrike, ujë riparime etj, me vlerë 6.000.000 lekë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mjedisit, Drejtoria e Financës si dhe Drejtoria e Qendrës Ekonomike të Çerdheve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI

